



BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

NËNTOR 2024

ÇERTIFIKIMI I STUDENTËVE, TË KLINIKAVE TË LIGJIT PËR PRAKTIKËN 3 MUJORE TË PUNËS



U çertifikuan nga Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja dhe Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici 97 studentë, të Klinikave Ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, të cilët kryen praktikë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, për periudhën Mars- Maj 2024.



GJYQËSORI & NDËRMJETËSIMI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN, NË SARAJEVË



Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z.Ergys Qirici prezent në Konferencën Rajonale me temë "Justice and Mediation for EU Integration", në Sarajevë, përkrah përfaqësuesve të ndryshëm nga gjyqësori dhe sistemet e ndërmjetësimit në të gjithë Evropën Juglindore.

NJOHJA E SË DREJTËS PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË NDËRMJETËSIT MIDIS SHQIPËRISË DHE KOSOVËS



Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici mori pjesë në Ceremoninë zyrtare të njohjes të së drejtës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësimit, e cila u finalizua me nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike për njohjen e ndërsjelltë të profesionit të ndërmjetësimit midis Shqipërisë dhe Kosovës.

TË FUQIZOHEMI PËRMES INFORMACIONIT: NJË UDHËTIM ME MEDIAN KOMBËTARE PËR TË PRMOVUAR NDIHMËN JURIDIKE FALAS PËR PERSONAT VULNERABËL

Në bashkëpunim me UNDP, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici, me pjesëmarrjen e medias kombëtare vizituan dhe intervistuan Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, Lushnjë, Fier dhe Vlorë, mbi punën dhe suksesin e Ndihmës Juridike Falas.



"PROÇESI I RREGULLT LIGJOR DHE EDUKIMI LIGJOR I PUBLIKUT", PRANË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR.



Drejtor pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, zj.Patricia Pogaçe prezantoi në Tryezën e hapur publike me temë "Proçesi i rregullt ligjor dhe edukimi ligjor i publikut", organizuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, rolin dhe aksesin në drejtësi nëpërmjet Ndihmës Juridike Falas.



Kuçovë, Berat

Në kuadër të promovimit të Ndhmës Juridike Falas në çdo bashki, në datën 04.11.2024 në ambientet e Bashkisë Kuçovë, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndhmës Juridike Falas z.Ergys Qirici, kryetarit të Bashkisë z.Kreshnik Hajdari, si dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme lokale.

Pustec, Korçë



Në kuadër të promovimit të Ndhmës Juridike Falas në çdo bashki, në ambientet e Bashkisë Pustec, u zhvillua takimi me prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndhmës Juridike Falas z.Ergys Qirici, kryetarit të Bashkisë Pustec z. Pali Kolefski, nën kryetarit të Bashkisë, si dhe institucione të ndryshme lokale.

FUSHATA "16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE"



Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në takimin e organizuar nga Shërbimi Social Shtetëror, datë 26.11.2024.



QSHNJP Elbasan, në datën 25.11.2024 zhvilloi një aktivitet informues pranë Fondacionit "Joscelyn", në kuadër të "16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore".

QSHNJP Fier në datën 25.11.2024 iu bashkua fushatës sensibilizuese "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore" me një marshim të organizuar nga Bashkia Fier.

QSHNJP Tiranë më 26.11.2024, ishte e ftuar në aktivitetin në kuadër të "16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore", të organizuar nga SHSSH.



QSHNJP Korçë, në datën 06.11.2024, në bashkëpunim me Bashkinë Kolonjë organizoi një ditë të hapur me viktimat të dhunës në familje, përfitues të urdhërit të mbrojtjes, me persona përfitues të aftësisë së kufizuar dhe të moshuar përfitues të shërbimit pranë qendrës ditore.

QSHNJP Korçë, në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit të dhunës me bazë gjinore mori pjesë në aktivitetin e realizuar në Pedonalen e Qytetit nga Bashkia Korçë.

QSHNJP Korçë në datën 27.11.2024 mori pjesë në aktivitetin e realizuar në Shkollën Profesionale Korçë në kuadër të "16 ditëve të aktivizimit në kuadër të dhunës me bazë gjinore".



QSHNJP Durrës, mori pjesë në datën 14.11.2024 në një aktivitet ndërgjegjësues, në bashkëpunim me Qendrën Komunitare Multifunksionale Rashbull, me temë: "Parandalimi i dhunës në familje".

QSHNJP Durrës, mori pjesë në datën 15.11.2024 në një aktivitet ndërgjegjësues, pranë Shkollës 9 vjeçare "Vëllezërit Haradinaj" me temë: "Parandalimi i dhunës në familje".



QSHNJP Lezhë, në datën 25.11.2024, ka marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Social me fokus sensibilizimin e të rinjve kundër dhunës.

QSHNJP Lezhë, ishte e ftuar në një aktivitet të mbajtur nga Drejtoria e Shërbimit Social lidhur me dhunën me bazë gjinore.



QSHNJP Elbasan, në datën 26.11.2024, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në bashkitë e vogla, organizoi një takim me përfaqësues të Bashkisë Gramsh dhe qytetarë përfitues të ligjit nr. 111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti".



QSHNJP Elbasan, zhvilloi një aktivitet "Street Law" në qytetin e Elbasanit, në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit.



QSHNJP Fier zhvilloi në datën 26.11.2024 një aktivitet ndërgjegjësues "Street Law" në kuadër të "80 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë".

QSHNJP Tiranë në bashkëpunim me ndërmjetesen Zj. Enkelejda Gashi, në datën 14.11.2024, zhvilluan një takim me Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave në Tufinë, ku u diskutuan problematikat e femrave në procesin e divorcit.

QSHNJP Tiranë, në datën 27.11.2024, zhvilloi një aktivitet informues "Street Law" pranë Bulevardit Zogu i Parë, Tiranë.



QSHNJP Korçë realizoi në datën 01.11.2024 një aktivitet informues mbi ligjin Nr. 111/2017 'Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti', në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social dhe përfitues të ndihmës ekonomike .



QSHNJP Korçë organizoi në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit një takim me Organizatën e Veteranëve Korçë dhe familjarë të dëshmorëve një takim informues mbi ligjin nr.11/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti".




QSHNJP Dibër, më 13.11.2024 , mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga prezenca e OSBE në vendin tonë. Takimi u zhvillua në formën e një tryeze të rrumbullakët me temë: "Rritja e dialogut ndërmjet IKDNJ- ve, përfaqësuesve të bashkive dhe OSHC – ve në Bashkinë Dibër".

QSHNJP Dibër, në datën 26.11.2024, mori pjesë në aktivitetet e ndryshme të zhvilluara në kuadër të festave të Nëntorit, në qytetin e Peshkopisë. Të pranishëm në aktivitete ishin dhe përfaqësues të institucioneve të qarkut Dibër.



QSHNJP Vlorë, më datë 24.11.2024, zhvilloi një takim me familjet e Dëshmorëve të Luftës Nacional Çlirimtare dhe me anëtarë të Organizatës së Dëshmorëve të Luftës.

QSHNJP Gjirokastrë & Përmet, më 18.11.2024 , mori pjesë trajnimit e dedikuar rritjes së kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe barazinë përpara ligjit, të organizuar nga FSHDPAK, ANAD dhe DSA.



QSHNJP Gjirokastrë & Përmet në kuadër të 80 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, 28-29 Nëntorit, organizuan një aktivitet informues "Street Law".

QSHNJP Gjirokastrë, më datë 19.11.2024, realizoi një intervistë me median lokale RTGJ mbi shërbimet juridike falas dhe kategorinë e personave të cilët përfitojnë akses në drejtësi pa kosto.

QSHNJP Durrës realizoi më datë 06.11.2024 një takim informues mbi Ndhimën Juridike Parësore, në bashkëpunim me Oficerin e Sigurisë së Gjimnazit "Leonik Tomeo" Durrës.

QSHNJP Durrës, në bashkëpunim me me studentë të Klinikës Ligjore të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës në datë 08.11.2024 organizoi një aktivitet ndërgjegjësues "Street Law".

QSHNJP Durrës, në bashkëpunim me studentë të Klinikës Ligjore të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës në datë 11.11.2024 në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimi të qytetarëve, ka organizuar një sesion informimi "Street Law" mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti





QSHNJP Durrës, më 12.11.2024, zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me Oficerin e Sigurisë së Gjimnazit "Leonik Tomeo" Durrës Z. Aleksandër Gjeçi mbi të drejtat dhe detyrimet e të miturve përpara ligjit.



QSHNJP Durrës, mori pjesë në datën 18.11.2024 në një takim ndërgjegjësues në Qendrën Ditore e të moshuarëve në kuadër të Ditës Botërore për "Parandalimin dhe shërimin nga shfrytëzimi seksual i fëmijëve, abuzimi dhe dhuna".



QSHNJP Durrës, zhvilloi në datën 20.11.2024 një aktivitet informues në bashkëpunim me Gjimnazin "Beqir Çela" Durrës, Organizatën "Ushten" dhe Qendrën për Shërbimet mbrojtëse fuqizuese dhe emergjente për fëmijet dhe familjen.



QSHNJP Durrës, Durrës në kuadër të 80 vjetorit të Çlirimit me datë 27.11.2024, ka organizuar një sesion informimi "Street Law" mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë "Promovimi i Ndihmës Juridike Falas".

QSHNJP Përmet, në datë 07.11.2024, ishte e ftuar për të marrë pjesë në takim me Shoqatën e të Verbërve të Degës Përmet si dhe anëtarët e kësaj shoqate.

QSHNJP Përmet, në datë 15.11.2024, ishte e ftuar për të marrë pjesë në takim me gratë rurale dhe përfaqësues të institucioneve nga Bashkia Përmet.



QSHNJP Përmet, në datë 27.11.2024, Qendra e Përmetit zhvilloi aktivitet street law për 80-vjetorin e Çlirimit. Qytetarët u informuan mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" si dhe kategoritë përfituese.



QSHNJP Lezhë ka organizuar me rastin e 28 - 29 Nëntorit një aktivitet informues "Street Law".

QSHNJP Lezhë, më datë 26.11.2024, ka kryer një kontroll mbi vendosjen e posterave të Ndihmës Juridike Falas në institucione të ndryshme.

QSHNJP Shkodër organizoi një prezantim të zyrës si një zyrë e re në këtë rreth, pjesë e QNJFSH, në shoqatën "MEDPAK" Koplik.

QSHNJP Shkodër ka zhvilluar promovimin e zyrës në institucionet e tjera shtetërore, konkretisht në Komisaratin e Malësisë së Madhe.



QSHNJP Shkodër ka zhvilluar një aktivitet informues në Zyrën e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore nën praninë e punonjësëve të këtyre zyrave.



QSHNJP Shkodër, në datë 06.11.2024, ka kryer shpërndarjen e certifikatave për studentët e Klinikave të Ligjit pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi", për trajnimin e kryer nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

QSHNJP Shkodër, më 12.11.2024, ka qenë pjesë e trajnimit për rritjen e kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe barazinë para ligjit. Trajnimi u vu në zbatim nga FSHDPAK, ANAD dhe DSA.



QSHNJP Shkodër, në datë 27.11.2024, së bashku me anëtarë të LANÇ Shkodër, mori pjesë në aktivitetin pranë Shkolles së Muzikes "Preng Jakova", Shkodër. Aktiviteti u mbajt në kuadër të festave të Nëntorit.



QSHNJP Pogradec, në datën 19.11.2024, në kuadër të datës 18 Nëntor - Dita Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna me mbështetjen e Shërbimit Psikosocial, Pogradec organizoi në Shkollën 9 vjeçare "M.E Minarolli", një takim informues me këtë temë.



QSHNJP Pukë, më datë 12.11.2024, organizuan një aktivitet informues pranë shkollës 9 vjeçare 'Migjeni' mbi Ndihmën Juridike Falas si edhe parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit të të miturve.

QSHNJP Pukë, më datë 26.11.2024, ka zhvilluar një aktivitet për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e dëshmorëve.



QSHNJP Kavajë, më 04.11.2024, organizoi në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë një takim në kuadër të promovimit të Ndihmës Juridike Falas në bashkitë e vogla.

QSHNJP Kavajë, në datën 05.11.2024, mori pjesë në takimin e organizuar nga TLAS në bashkëpunim me IEVP Kavajë mbi drejtësinë për të miturit dhe integrimin e tyre në shoqëri pas vuajtjes së dënimit.

QSHNJP Kavajë organizoi një takim me institucionet lokale në Bashkinë e Kavajës në kuadër të ditës botërore për *"Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna"*



QSHNJP Kavajë, në datën 20.11.2024, mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të promovimit të punës së qendrave të Ndihmës Juridike Falas.

QSHNJP Kavajë, mori pjesë në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të festave të Nëntorit, pranë Bashkisë Kavajë.



QSHNJP Tropojë, në datën 21.11.2024 mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët organizuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



QSHNJP Tropojë, më datë 27.11.2024, organizoi një takim me përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve Tropojë dhe Shoqatës së Dëshmorëve Tropojë.



QSHNJP Kurbin, më datë 21.11.2024, realizoi zhvillimin e një sesiioni informues *"Street Law"* mbi Ndihmën Juridike Parësore.

QSHNJP Kurbin, më datë 26.11.2024, ka zhvilluar një sesion informues *"Street Law"* në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit.



QSHNJP Kurbin, më datë 27.11.2024, ka zhvilluar një sesion informues *"Street Law"* në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit.